

EPPC Albania kërkon një **Menaxher të Përgjithshëm Hoteli**, për klientin e saj, një ndër hotelet më prestigjioze dhe me histori suksesi në vend.

### MUNDËSIA JUAJ

Klienti është në kërkim të një kandidati i cili duhet të ketë përvojë në menaxhim në sektorin e Hoteleri-Turizmit. Ai/Ajo do të jetë përgjegjës për të mbajtur standardet më të mira të shërbimit, shëndetit, ushqimit, sigurisë në punë, si edhe për performancën financiare.

### **Përgjegjësitë Kryesore:**

- Plotëson nevojat e hotelit me staf, duke përzgjedhur, trajnuar, monitoruar dhe vlerësuar punën e tyre nëpërmjet dhënies së feedback-ut të vazhdueshëm;
- Përgatit plane konkrete me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të shërbimeve në hotel;
- Përgatit buxhetin vjetor, identifikon dhe vlerëson risqet dhe shpenzimet, arrin objektivat financiarë;
- Drejton dhe monitoron fushatat e marketingut;
- Menaxhon dhe mirëmban marrëdhëniet me kontraktorët dhe furnitorët;
- Monitoron dhe mirëmban ambientet si dhe shërbimet e ofruara;
- Kujdeset të sigurojë përpuethshmërinë me procedurat dhe ligjet mbi licensimin, shëndetin dhe sigurinë.

### **Kërkesat për këtë pozicion janë:**

- Diplomë Universitare, e preferueshme në **Menaxhim/Administrim Biznes/Hoteleri Turizëm**;
- **Përvojë e mëparshme në sektorin e hoteleri-turizmit, në nivele drejtuese jo më pak se 5 vjet**;
- Aftësi drejtuese, udhëheqëse, organizative dhe vendimmarrëse;
- **Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe MS Office**;
- **Integritet, dhe besueshmëri profesionale**;
- Përgjegjshmëri dhe qëndrim korrekt me stafin dhe klientët.

### **Të dhënat:**

<b>Pozicioni:</b>	Menaxher i Përgjithshëm Hoteli;
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë;
<b>Pagesa:</b>	Pagë në nivel drejtuesi;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	19 Tetor 2018.

### **Si të aplikoni:**

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[tianda.nano@eppc.al](mailto:tianda.nano@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.